



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.91/24

Datë: 03.10.2024

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 03.10.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi lidhur me blerjen e aksioneve nga Orbico d.o.o (blerësi) mbi HBI Italy Acquisition o.S.r.l., dhe Authentic Brands Group LLC (shitësi).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 27.08.2024, me Nr. Prot. 549/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit përmes znj. Blerina Strana - Përfaqësuese Ligjore lidhur me blerjen e aksioneve nga Orbico d.o.o (blerësi) mbi HBI Italy Acquisition o.S.r.l., dhe Authentic Brands Group LLC (shitësi).

Orbico d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të biznesit: 85611744662, Adresa: Koturaška Cesta, 69, 1000 Zagreb, Croatia. Aktiviteti i shoqërisë: Shitje me shumicë dhe shpërndarje. Në Kosovë Orbico ka degë të regjistruar. Orbico Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të biznesit, me numër të regjistrimit të biznesit 810501800, e cila merret kryesisht me mallrat e konsumit me lëvizje të shpejtë (FMCG) dhe Beauty.

HBI Italy Acquisition o.S.r.l ("HBI") Limited Liability Company me numër të biznesit: 435266 me Adresë: Via Dell Agricoltura 51, Carpi (MO), CAP 41012, Itali . Aktiviteti i shoqërisë: Veprimtaritë e kompanive Holding,

Authentic Brand Group LLC (“ABD”) është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të biznesit: 4789754, me Adresë: 251 Little Falls Drive, Wilmington, New Castle County, Delaware, 19808, Nju Jork. Aktiviteti i shoqërisë: blerjen, zotërimin, zhvillimin, funksionimin, menaxhimin, financimin, licencimin, shitjen dhe shfrytëzimin e markave të konsumatorit etj.

Procedurat e ndjekura:

- Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 03.09.2024
- Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 04.09.2024
- Me datë 30 Prill 2024, Palët kanë nënshkruar kontrate mbi shitblerjen e pasurive të palujtshme.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- I. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- II. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.

Palët në Përqendrim:

Orbico, në Kosovë, është mbajtës i 51 % të aksioneve në kompaninë Orbico Shpk, ku ekskluzivisht realizohet qarkullimi në Kosovë. Orbico sh.p.k, është një kompani me përgjegjësi të kufizuara e regjistruar në ARBK me numër identifikues 810501800, e angazhuar në tregjet e mallrat e konsumit me lëvizje të shpejte (FMCG) dhe Beauty (“Orbico Kosova”). Orbico Kosova luan edhe një rol të rëndësishëm edhe në tregun e Bukurisë, duke u fokusuar edhe në kozmetik, parfume dhe produkte make-up të nivelit të lartë.

ABG dhe HBI Italy nuk operojnë dhe për këtë arsyeje nuk gjenerojnë asnjë qarkullim në Kosovë.

Struktura e Përqendrimit:

Marrëveshjen e lidhur me datë 30 Prill 2024, ndërmjet Orbico në cilësinë e blerësit dhe Authentic Brand Group LLC, në cilësinë e shitësit mbi HBI Italy Acquisition o.S.r.

Prandaj, transaksioni përfaqëson blerjen nga Aplikanti të 100% të aksioneve në HBI Italy. Si rezultat i zbatimit blerësi do të marr kontrollin e vetëm mbi HBI Italy dhe kontrollin e vetëm 100% mbi filialet dhe degët e tije si rezultat i një blerjeje të kontrollit të vetëm nga Aplikuesi mbi Targetin.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit, Sa i përket tregut përkatës të produkteve, duhet theksuar se Orbico në Kosovë angazhohet në mënyre aktive si në tregun e FMCG ashtu edhe në atë të Bukurisë,

duke zbatuar një strategji të njëkohshme në këta sektorë. Brenda sektorit të FMCG, Orbico Kosova fokusohet në mënyre specifike në segmentin e Ushqimit, me një theks të dukshëm në drithërat dhe ushqimet. Për më tepër Orbico Kosova merr pjesë edhe në tregun jo-ushqimor, veçanërisht në bateri. Orbico Kosova luan një rol të rëndësishëm edhe në tregun e bukurisë, duke u fokusuar në kozmetik, parfume dhe produkte make-up të nivelit të lart.

Tregu përkatës gjeografik, Sipas udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të thotë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinje në transaksionin e propozuar do të konsiderohet si treg ndërkombëtar, përfshirë edhe Republika e Kosovës.

Analiza e konkurrencës

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.08/L-056 për mbrojtjen e Konkurrencës, llojet e Përqendrimit që kapen nga rregullat e kontrollit të bashkimit janë ato që plotësojnë dy kushte: transaksioni duhet të përbejë një Përqendrim sipas kuptimit të nenit 11 të ligjit të konkurrencës dhe duhet të plotësohet pragu i qarkullimit të parashikuar në nenin 13 të ligjit të konkurrencës.

Përqendrimi konsiston në blerjen nga Orbico d.o.o (“Bleresi”) i të gjithë stokut të kapitalit të emtuar dhe të papaguar të HIB Italy Acquisition Co.S.r.l.(“Objektivi”) nga Authentic Brands Group LLC(“Shitesi”), blerësi synon të blejë të gjitha aksionet e Objektivit nga Shitesi.

Prandaj, transaksioni përfaqëson blerjen nga Aplikanti të 100% të aksioneve në HBI Italy. Si rezultat i zbatimit, Blerësi do të marr kontrollin e vetëm mbi HBI Italy dhe kontrollin e vetëm 100% mbi filialet dhe degët e tij si rezultat i një blerjeje të kontrollit të vetëm nga Aplikuesi mbi Targetin. Palët në përqendrim nuk kanë pjesëmarrje tjera në tregun përkatës. Transaksioni zbatohet dhe ka efekte jashtë territorit të Kosovës. Prandaj transaksioni në fjale nuk kontestohet nga këndvështrimi i rregulloreve për mbrojtjen e konkurrencës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Arsyeja e kërkesës së njoftimit për përqendrim është se transaksioni fillestar paraqet një përqendrim në kuptimin e nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe për këtë arsyeje i njoftohet Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Ky transaksion nuk do të ketë ndikim në produktet e lartpërmendura në Kosovë pasi i gjithë transaksioni dhe efektet e tij do të jenë të dukshme në Itali, dhe në vendet ku objektivi ka filialet e saj., duke pasqyruar se as HBI dhe as Shitesi nuk operojnë ndonjë biznes në Kosovë. Nuk ka marrëdhënie vertikale ndërmjet kompanive të portofolit të kontrolluara nga Orbico në Kosovë. Prandaj transaksioni nuk do të ketë ndikim në këto tregje dhe segmente të tyre në juridiksionin e Kosovës. Transaksioni nuk do të ketë efekte në tregun e Kosovës, prandaj nuk do të ndikojë në interesat e konsumatorëve.

Komisioni i Konkurrencës, ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë, nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI



Nejme Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdataj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva